



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Detyrimet kontigjente të prezantuara në pasqyrat financiare nuk janë gjithëpërfshirëse dhe të plota, dhe se 325 lëndë kontestimore janë prezantuar me vlerën zero.
- B2 Shpenzime në vlerë 144,267€ nuk janë regjistruar në kategoritë përkatëse ekonomike.
- B3 Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 32,541€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vonesa në realizim të projekteve kapitale dhe mos mbulim i kontratave me siguri të ekzekutimit.
- B4 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare.
- A2 Parregullsi në procedurat e prokurimit publik.
- A3 Zotimi i mjeteve financiare në SIMFK pas nënshkrimit të kontratave publike.
- A4 Parregullsi në proceset e subvencionimit të OJQ-ve dhe fermerëve.
- B5 Kosto shtesë si rezultat i pagesave nga vendimet gjyqësore / përmbarimore.
- A5 Ndërrim i kontratës së punës me kohë të caktuar, në kontratë me kohë të pacaktuar.
- A6 Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat që kërkojnë përmirësim kryesisht janë: prokurimi publik dhe menaxhimi i kontratave, subvencionet dhe mbikëqyrja e implementimit të projekteve të subvencionuara, klasifikimi i shpenzimeve në kategori përkatëse, menaxhimi i personelit, pasurisë, llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontigjente, etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre 8 janë rekomandime të reja, 5 të përsëritura dhe 1 rekomandim pjesërisht i zbatuar.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Shpalosje jo e plotë e detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare

Gjetja

Me Rregulloren MF - Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 18 përcakton që OB në harmoni LMFPP-në raporton të gjitha detyrimet kontigjente në raportin vjetor financiar.

Detyrimet kontigjente nuk janë shpalosur në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse në pasqyrat financiare. Gjatë vitit 2022, komuna ka bërë një rishikim të listës por nuk ka arritë të ketë një evidencë të plotë të regjistrit të lëndëve kontestimore përgjatë viteve, duke regjistruar vetëm ato të vitit 2021 dhe 2022. Vlera e detyrime kontigjente e prezantuar në pasqyrat financiare është 2,351,332€. Në aneksin e pasqyrave financiare, përveç rasteve kur është vlerësuar vlera e kontestit, janë shpalosur edhe 325 raste apo padi që i përkasin kategorisë së investimeve kapitale dhe pagave e mëditjeve, me vlerë zero apo pa ndonjë vlerë financiare të kontestit. Nga tri mostra të testuara të prezantuara me vlerë zero, kemi konstatuar se vlera e padive është 6,000€.

Kjo ka ndodhur për të shkak të kontroleve joadekuate si dhe paqartësisë rreth të dhënave për detyrimet kontigjente, dhe mos koordinimit të duhur të informacionit në mes zyrës ligjore të komunës dhe kontraktuesit ligjor apo përfaqësuesit të komunës.

Ndikimi

Shpalosja e detyrimeve kontigjente në vlera jo të plota ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e pasqyrave financiare të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontigjente.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë një koordinim të duhur të informacionit dhe përmirësim të komunikimit në mes departamenteve, në mënyrë që të

sigurohen evidenca të sakta dhe të plota të detyrimeve kontingjente për prezantim në pasqyrat vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Regjistrim i shpenzimeve në kategori ekonomike joadekuate

Gjetja Ligji Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve përshkruan qartë definicionet e kategorive ekonomike që i përdor Thesari për të regjistruar dhe raportuar shpenzimet e qeverisë.

Nga mostrat e testuara, është evidentuar se:

- nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve janë paguar 100,000€ për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrugëve me asfalt, që për nga natyra shpenzimi i takon investimeve kapitale; dhe
- si rezultat i vendimeve gjyqësore / përmbarimore, pagesat direkte nga Thesari nga buxheti për investime kapitale ishin 44,267€ për pagesën e shujtave, e që për nga natyra i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të vendimeve gjyqësore si dhe mos planifikimit të duhur të shpenzimeve në kategoritë përkatëse ekonomike.

Ndikimi Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme nga taksat për mbeturina

Gjetja Neni 16 i Rregullores MF-Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar përcakton që OB që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Sipas regjistrimit analitik, llogaritë e arkëtueshme nga taksat për mbeturina ishin 4,602,730€, ndërsa në pasqyrat financiare janë shpalosur në vlerën 4,635,271€, duke mbivlerësuar saldon e të arkëtueshmëve për 32,541€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve joadekuate në mbajtjen e

regjistrave për llogaritë e arkëtueshme nga drejtoria përkatëse.

Ndikimi

Mangësitë në regjistra ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme në pasqyrën financiare, e të cilat mund të kenë ndikim negativ në vendimmarrjen e menaxhmentit, dhe informacion jo të saktë ndaj palëve të interesit.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesë në realizim të projekteve kapitale dhe mangësi në sigurim dhe garancion të punimeve të realizuara

Gjetja

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet afati kohor i realizimit të projekteve, vlera (përqindja) dhe afati kohor i sigurisë së ekzekutimit të kontratës, si dhe afati kohor i garancionit të punimeve.

Vonesa në realizim të projekteve kapitale janë hasur te:

- Projekti për Ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Zym, në vlerë 392,968€, e nënshkruar me datë 07.11.2019 dhe me plan dinamik të realizimit për 300 ditë pune, është përfunduar me vonesë prej 212 ditëve. Në raportin përfundimtar të përgatitur nga mbikëqyrësi i projektit nuk janë dhënë informacione apo arsyetime për vonesat në realizim të projektit. Siguria e ekzekutimit të kontratës kishte skaduar më datë 08.02.2021, dhe nuk ishte kërkuar vazhdimi i saj. Gjithashtu, siguria e garancionit të punimeve ishte bërë vetëm për 1 vit, ndonëse me kontratë është kërkuar garancion prej 3 viteve nga data e pranimit teknik të punimeve. Pas shqyrtimit të lëndës gjatë punës audituese, OE ka siguruar sigurimin shtesë të garancionit të punimeve edhe për dy vite tjera.
- Projekti për Ndërtimin e infrastrukturës në fshatin Malësi e Vrrinit, në vlerë 108,825€, e nënshkruar në fund të vitit 2021, dhe e planifikuar të realizohet për 150 ditë pune, nuk është përfunduar as deri në muajin prill 2023. Siguria e ekzekutimit të kontratës për këtë projekt ishte bërë për afatin 6 muaj apo deri 30.06.2022. Nga kjo kohë deri më 28.03.2023, kur kemi shqyrtuar/audituar lëndën, kontrata ishte pa mbulesë të sigurisë. Më pas është sjellë siguria e re e ekzekutimit për afatin 1 vjeçar.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave publike, derisa vonesat në realizim për shkak mungesës së mjeteve buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara. Më tutje, mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkalim ligjor, rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë. Siguria e ekzekutimit të kontratës dhe garancioni i punimeve të bëhen në vlerën dhe afatin e përcaktuar me kushtet e veçanta të kontratës. Në rastet kur projektet tejkalojnë planin dinamik të realizimit, sigurimi i ekzekutimit të kontratës duhet të vazhdohet dhe të mbulojë periudhën kohore deri në realizim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

Gjetja LMFPF dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Katër pagesa për investime kapitale në vlerë 187,358€, dhe tri pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 41,380€, janë realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Vonesat ishin nga 1 deri 237 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore.

Ndikimi Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave apo padive të mundshme nga kontraktuesit, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për Komunën.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar në paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në procedurat e prokurimit publik

Gjetja Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen nga ofertuesit. Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik neni 28, dhe Rregullës dhe Udhëzuesit të prokurimit publik neni 19.6, kërkohet që dosja e tenderit të përgatitet në atë mënyrë që nuk diskriminon ose vepron në favor të një ose më shumë OE. Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet vlera (përqindja) dhe afati kohor i sigurisë së ekzekutimit (SE) të kontratës, Me nenin 26.9 të Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik, përcakton që sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, kemi identifikuar mangësitë te projektet si në vijim:

- Ndërtimi i rrugës tranzitore - kryqëzimi me autostradën në Prizren, në vlerë 785,055€, një nga kriteret ishte që OE duhet të ketë një inxhinier të diplomuar të komunikacionit, me përvojë pune jo më pak se 3 vite. OE kishte sjellë vetëm diplomën e punonjësit por jo edhe dëshmitë për përvojën e punës.
- Furnizim me pajisje stomatologjike për nevojat e departamentit të stomatologjisë në vlerë 25,750€, një nga kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë ishte ofrimi i katalogut nga prodhuesi me specifikimet teknike për pajisjet e ofruara. OE fitues kishte ofruar specifikacion teknik vetëm për njërin pajisje (printer), ndërsa për pajisjet tjera nuk kishte ofruar katalog me specifikacione teknike, por ka ofruar vetëm foto të pajisjes. Po ashtu, si kriter është kërkuar autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim të pajisjeve, ndërsa OE ka sjellë dy autorizime nga prodhuesi vetëm për shitje, por jo edhe për servisim të pajisjeve, dhe që Autorizimet nuk përmbanin emërtimet e llojit të pajisjeve që janë ofruar nga OE.
- Renovimi i qendrës sportive Sezai Surroi në Prizren, në vlerë 518,036€, në paramasë / specifikacion teknik është përcaktuar marka tregtare apo lloji i pajisjeve. Në parallogari ishte caktuar lloji apo modeli i Termo Pompës Hisense, si dhe kaloriferëve të modelit Sonnigei.
- Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në komunën e Prizrenit, me vlerë të parashikuar 1,500,000€, me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar sigurimi i ekzekutimit në 10% të vlerës së parashikuar të kontratës në afat prej 37 muajve. Para nënshkrimit të kontratës, OE kishte sjellë sigurimin në vlerë 150,000€ në afat prej 12 muajve, e jo për 37 muaj. Pas skadimit të sigurimit, është bërë sigurimi i dytë në vlerë 59,797€ në afat 12 muaj, dhe pas skadimit të sigurimit të dytë është bërë sigurimi i tretë në vlerë 21,500€ në afat 12 muajor.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontroleve të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit dhe në procesin e vlerësimit të tenderëve.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuara më sipër mund të ndikojnë që kontraktuesit mund të mos jenë të përgjegjshëm dhe të mos kenë kapacitetet profesionale njerëzore në realizimin e projekteve të kontraktuara. Më tutje, përcaktimi i markës tregtare apo modelit në specifikimet e dosjes së tenderit ndikon në favorizimin e operatorit/ve të caktuar për llojin e caktuar të produktit duke kufizuar konkurrencën.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Specifikimet teknike të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, duke mos përdorur emrin e markës tregtare apo modelit që favorizon apo diskriminon ndonjë OE. Gjithashtu, të sigurohet se sigurimi i ekzekutimit të kontratës bëhet në vlerën dhe afatin e përcaktuar me njoftimin për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratave publike**Gjetja**

Neni 36.1 i ligjit 05/L-063 LMFPP, përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK.

Në tre raste zotimet e mjeteve në SIMFK ishin bërë pas nënshkrimit të kontratave publike. Rastet kanë të bëjnë me projektet për:

- Ndërtimin e qendrës së mjekësisë familjare në ambientet e ish KFOR-it në Prizren (projekt tre vjeçar), në vlerë 2,323,000€, e nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore në SIMFK. Zotimi i pjesshëm i mjeteve është bërë dy muaj pas nënshkrimit të kontratës, atëherë kur është paguar situacioni i parë i punimeve. Një pjesë e zotimi ishte bërë në vitin 2021 kur ishte inicuar procedura e prokurimit, derisa kontrata është nënshkruar me datë 27.05.2022.
- Ndërtimin e infrastrukturës në fshatin Krushë e Vogël (projekt dy vjeçar), në vlerë 121,555€, e datës 02.02.2022, e nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore në SIMFK. Zotimi i pjesshëm i mjeteve është bërë gati 3 muaj pas nënshkrimit të kontratës, atëherë kur është paguar situacioni i parë i punimeve.
- Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe i zonave periferike, në vlerë të parashikuar 210,000€, ishte nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve financiare. Zotimi i pjesshëm për këtë kontratë ishte bërë një muaj pas datës së nënshkrimit. Kontrata është nënshkruar më datë 30.03.2022, ndërsa një pjesë e zotimit të mjeteve është bërë në vitin 2021, pasi si procedurë e prokurimit kishte filluar në vitin 2021.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyra e prokurimit ka konsideruar që zotimet e mjeteve janë bërë në vitin paraprak, dhe nuk është e nevojshme të ri-zotohen mjetet në vitin kur është nënshkruar kontrata.

Ndikimi

Përgatitja e zotimit me vonesë mund të ndikojë që kontratat publike të mos realizohen me kohë në mungesë të zotimit të mjeteve buxhetore në SIMFK.

Rekomandimi A3

Kryetari të sigurojë se para nënshkrimit të kontratave publike mjetet financiare zotohen në SIMFK. Në rastet kur procedurat e prokurimit për arsye objektive nuk finalizohen në vitin fiskal kur është filluar procesi i kontraktimit, atëherë ri-zotimi i mjeteve në SIMFK të bëhet në vitin vazhdues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në proceset e subvencionimit**Gjetja**

Në pikën 6 të manualit të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, janë përcaktuar kërkesat dhe formularët zyrtar që OB duhet të përdorin gjatë procesit të subvencionimit. Gjithashtu, te neni 7, kërkohet që ofruesi i mbështetjes financiare cakton zyrtarin përgjegjës me qëllim monitorimin e zbatimit të projektit dhe vlerësimit të përmbushjes objektivave. Me thirrjen publike për fushën e sportit, është kërkuar që klubi të ketë së paku dy trajner të licencuar, ndërsa te thirrja publike për bujqësi, është kërkuar nga dëshmia për verifikimin e kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Gjithashtu, me marrëveshjet e financimit në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ-ve përfituese është përcaktuar që përfituesi duhet të dorëzojë raport financiar dhe narrativ pas përfundimit të projektit të subvencionuar.

Mangësitë e hasura në proceset e subvencionimit kanë të bëjnë me:

- Komisionet e vlerësimit të kërkesave për subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit nuk kanë aplikuar formularët zyrtar të vlerësimit të kërkesave, siç kërkohet me Rregulloren MF-Nr-04/2017. Kjo është hasur në pesë mostra të testuara, e të cilat ishin në vlerë të përgjithshme 54,550€. Gjithashtu, kryesuesi i komisionit të vlerësimit të kërkesave ishte caktuar monitorues i projekteve të financuara. Monitoruesi nuk kishte përgatitur ndonjë raport pune rreth projekteve të subvencionuara apo nëse ka realizuar ndonjë vizitë në mbikëqyrjen e projekteve;
- Me thirrjen publike në fushën e sportit, lot 2, përveç kriterëve tjerë është kërkuar që ekipi i futbollit të ketë së paku 2 trajner të licencuar. Përfituesi i projektit Masovizimi i futbollit prizrenas, në vlerë 30,000€, kishte sjellë një konfirmim me shkrim për trajnerët, por emrat e listuar në konfirmim nuk figuronin në regjistrin e lëshuar nga Lidhja Rajonale e Futbollit - Prizren. Përfituesi i subvencionit nuk kishte sjellë dëshmitë/licencat e trajnerëve;
- Te procedurat e subvencionimit të prodhuesve të qumështit, përveç kriterëve tjerë për aplikim, ishte kërkuar nga fermerët dëshmia për verifikimin e kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV. Përfituesi/fermeri kishte sjellë një dokument të nënshkruar dhe vulosur nga vet fermeri për numrin e kafshëve, e jo nga AUV; dhe
- Në dy raste përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raporte narrative dhe financiare për projektet e financuara nga Komuna. Projekti i parë në vlerë 45,000€ i takon fushës së sportit për pjesëmarrje në garat kombëtare të basketbollit, dhe projekti i dytë në fushën e rinisë për promovimin e punës vullnetare në vlerë 4,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin e proceseve të subvencionimit nga komisionet vlerësuese, dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga monitoruesit e projekteve.

Ndikimi

Mos aplikimi i kërkesave ligjore, ndikon që procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të mos zhvillohet si duhet, dhe rritë mundësinë që të ketë trajtim jo të barabartë të përfituesve. Më tutje, monitorimi i realizimit të projekteve nga kryesuesi i komisionit të vlerësimit bie ndesh me

parimin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi. Në mungesë të raporteve narrative dhe financiare nuk krijohet siguri se fondet financiare janë shfrytëzuar nga përfituesit për qëllimin e dedikuar.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit shqyrtojnë aplikacionet në përputhje me kriteret e përcaktuara me thirrjen publike, dhe se përdorin formularët zyrtar të procesit të subvencionimit të OJQ-ve siç përcaktohet me rregullore. Po ashtu, monitorues të realizimit të projekteve të subvencionuara të mos jenë anëtarët e komisionit të vlerësimit të kërkesave. Gjithashtu të sigurohet se, monitoruesit e projekteve të mbikëqyrin realizimin e projekteve të subvencionuara dhe se përfituesit dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar pas përfundimit të projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përmbartimore

Gjetja Neni 40.1 i LMFPP, përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Si pasojë e pagesave nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, Komuna e Prizrenit ka paguar në emër të kamatave dhe procedurave të përmbartimit vlerën prej 205,872€. Në total pagesat përfshirë borxhin kryesor dhe kamatat ishin 1,688,164€. Nga kjo shumë, për paga e mëditje ishin paguar 588,064€, për mallra e shërbime 206,254€, shpenzime komunale 76,773€, dhe për investime kapitale 817,073€.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, dobësive në menaxhim të kontratave, vonesave në kompletim të lëndëve, paqartësisë ligjore për pagesën e shujtave dhe pagave jubilarë, etj.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbartimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollat në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Ndërrimi i afatit të kontratës së punës, nga kohë e caktuar në kohë të pacaktuar

Gjetja Me nenin 66, të Ligjit për zyrtarët publik, përcaktohen kriteret për kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, përderisa me nenin 67, përcaktohet që themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të shërbimit publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur, të organizuar sipas këtij ligji.

Të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar në pozitën vozitës në QKMF, tre muaj para skadimit të kontratës i është bërë kontratë e re me afat të pacaktuar, pa u zhvilluar procedurë e re rekrutimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme në menaxhimin e personelit nga menaxhmenti i komunës.

Ndikimi Ndërrimi i kontratës së punës, nga afati i caktuar në afat të pacaktuar, bie ndesh me kërkesat për kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës të përcaktuar me ligjin për zyrtarët publik.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar angazhohen vetëm për afatin e caktuar me kontratë. Në rastet kur vlerësohet nevoja për punonjës të rregulltë, të zhvillohet procedura e rekrutimit përmes konkursit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese apo verifikimit të pronave

Gjetja Me ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15.2 përcakton se veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna nuk ka arritë që brenda vitit të verifikojë së paku 20% të objekteve të regjistruara. Nga 58,380 prona të regjistruara, gjatë vitit 2022 ishin verifikuar vetëm 9,155 objekte, apo 16% e objekteve të përgjithshme.

Kjo ka ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personelit të angazhuar në veprimtaritë inspektuese të pronave.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë së është arritur së paku 20% e verifikimit të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si: mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A7 - Parregullsi në menaxhimin e kontratave publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të poentuar (peshuar)

Gjetja

Siç shpjegohet me pikën 54.15 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, por edhe dhe në shpjegimin nr. 68, të KRPP-së, autoriteti kontraktues (AK) duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, por të ruajnë të njëjtin raport. Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit gjatë kontraktimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët,

Gjatë realizimit të tri kontratave publike me çmim të poentuar, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuara të kategorisë, dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Rastet janë hasur te:

- Kontrata publike për Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit, me vlerë totale të parashikuar 1,500,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në 5 kategori, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë C Shërbime me zhavor e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës apo deri në 300,000€, ishin shpenzuar 1,186,159€ apo 79% e vlerës së kontratës, duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuara dhe peshës së dhënë gjatë kontraktimit. Kategoria C kishte çmimin më të lartë të peshuar në krahasim me kategoritë tjera;
- Kontrata publike për Intervenimi dhe riparimi ne sinjalistiken e komunës së Prizrenit, ngritja e vendprirjeve për autobusët urbano-periferik dhe nëpër fshatrat e komunës së Prizrenit, me vlerë totale të parashikuar 250,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa ishte ndarë në 3 kategori, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë A Punët përgatitore e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 50,000€, deri në fund të vitit 2022 ishin shpenzuar 126,600€ apo 51% e vlerës së kontratës. Kjo kategori kishte çmimin për njësi më të lartë në krahasim me kategoritë tjera; dhe
- Kontrata publike për Renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës së Prizrenit, në vlerë të parashikuar 550,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën

kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në katër kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë B Furnizimi, punimi dhe monitimi, e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 110,000€, ishin shpenzuar 288,565€ apo 52% e vlerës së përgjithshme të kontratës, duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuara dhe peshës së dhënë gjatë kontraktimit. Kjo kategori kishte çmimin më të lartë të peshuar në krahasim me kategoritë tjera.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontroleve adekuate në menaxhimin e kontratave.

Ndikimi

Ndryshimi i raportit të peshimit apo përqindjes mes planifikimit dhe pagesave ndikon në mos realizim të kategorive tjera të kontraktuara. Devijimi nga përqindja apo pesha e kontraktuar gjatë realizimit të kontratës shkakton kosto më të lartë nga ajo e kontraktuar, për shkak se raporti i peshimit është faktor kryesor në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Në PVF e vitit 2022, Komuna e Prizrenit ka shpalosur pasuritë neto kapitale në vlerë 494,418,553€, pasuri jokapitale në vlerë 2,905,920€, dhe stoqe në shumën 1,102,536€.

Çështja C1 - Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria

Gjetja Me nenin 6.3 të Rregullores MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB, kërkohet që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Komuna nuk ka përdorur programin e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale. Në mungesë të përdorimit të sistemit e-pasuria, komuna kishte përdor formatin excel për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale, në të cilin ishin evidentuar edhe mostrat e testuara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në përdorimin dhe funksionalizimin e sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurisë jokapitale.

Ndikimi Megjithëse komuna kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në excel, përdorimi i regjistrave alternativ për evidentimin e pasurisë mund të reflekton negativisht në sigurinë, saktësinë, plotësinë dhe raportimin e drejtë të pasurisë jo kapitale.

Rekomandimi C1 Kryetari të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasuria për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2022 në total janë 18,936,616€. Saldo e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale, etj.

Çështja A8 - Rritje e saldos së llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 18,936,616€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (57%), taksat nga mbeturinat (24%), taksat për bizneset (13%), shfrytëzimi i pronës publike (5%) dhe nga urbanizmi (1%). Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, ku në krahasim me vitin paraprak, të arkëtueshmet janë rritur për 1,212,183€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

Rekomandimi A8 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁵ | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e fondeve | 47,788,685 | 55,333,114 | 46,266,941 | 50,185,605 | 44,966,504 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 40,614,658 | 42,118,372 | 36,663,440 | 41,768,695 | 37,528,620 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 359,900 | 359,900 | 311,911 | 526,542 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 4,749,585 | 3,934,810 | 2,405,653 | 2,514,548 |
| Të hyrat vetanake | 7,174,027 | 7,366,692 | 5,118,768 | 5,382,984 | 4,199,010 |
| Donacionet vendore | 0 | 488,808 | 41,530 | 315,934 | 132,793 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 249,757 | 148,492 | 428 | 64,992 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 7,544,429€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 4,749,585€, donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 738,565€, financimeve nga huamarrja në vlerë 359,900€, ndryshimi i të hyrave të planifikuara për 192,665€ dhe vendimeve të qeverisë në vlerë 1,503,713€.

Në vitin 2022 Komuna e Prizrenit ka shpenzuar 84% të buxhetit final apo 46,266,941€, me një ulje prej 7% në krahasim me vitin 2021. Buxheti nuk është realizuar në nivelin e pritur dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Prizrenit ka përfituar 1,352,660€ të hyra nga gjobat në trafik, 54,921€ nga gjobat e gjykatave, dhe 11,851€ të hyra nga Agjencia e Pyjeve. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës së Prizrenit i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 47,788,685 | 55,333,114 | 46,266,941 | 50,185,605 | 44,966,504 |
| Pagat dhe mëditjet | 20,845,757 | 21,860,277 | 21,098,714 | 24,546,533 | 20,582,472 |
| Mallrat dhe shërbimet | 6,970,550 | 10,528,245 | 10,135,739 | 8,170,451 | 7,438,923 |
| Komunalitë | 1,031,199 | 1,317,956 | 818,129 | 741,445 | 680,450 |
| Subvencionet dhe transferet | 950,000 | 2,682,038 | 2,562,388 | 2,562,240 | 1,877,050 |
| Investimet Kapitale | 16,546,972 | 17,629,598 | 11,651,971 | 14,164,936 | 14,387,609 |
| Rezervat | 1,444,207 | 1,315,000 | 0 | 0 | 0 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për Paga e Mëditje është rritur për 1,014,520€. Rritja është rezultat i pranimeve nga financimet e huamarrjeve në shumë 359,900€ me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të dedikuara për sektorin e shëndetësisë, donatorëve të jashtëm në vlerë 47,323€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shumë 73,745€, vendimeve të qeverisë në shumë 533,552€ dhe nga zvogëlimi të hyrave të planifikuara për 20,000€..
- Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur për 3,557,695€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 1,868,915€, vendimeve të qeverisë në shumë 1,680,000€ dhe nga pranimi i donacioneve në shumë 8,780€.
- Buxheti për Shërbime Komunale është rritur për 286,757€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shumë 246,757€ dhe vendimet e qeverisë në shumë 40,000€
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere është rritur për 1,732,038€. Rritja është rezultat i të hyrave të planifikuara për 930,000€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shumë 801,430, dhe donacioneve në vlerë 608€.
- Buxheti për Investime kapitale është rritur për 1,082,626€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 1,758,738€, donacionet 681,854€, zvogëlimi në të hyrat e planifikuara për 886,000€, dhe zvogëlimeve nga vendimet e qeverisë për 471,966€. Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 66% e buxhetit ishte shpenzuar, dhe kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të vonesave të kontraktimit si rezultat i ankesave në OSHP nga OE. Programi i Investimeve Publike përfshin 107 projekte në vazhdim nga viti i kaluar, dhe 14 projekte të reja për vitin aktual. Për 46 projekte me vlerë buxhetore 2,719,006€ nuk janë realizuar pagesa gjatë vitit 2022.
- Buxheti për Rezervat është zvogëluar për 129,207€. Kjo është ndikuar nga zvogëlimi i të hyrave të planifikuara për 381,446€ dhe rritjeve nga vendimet e qeverisë për 252,239€.

Komuna e Prizrenit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 389,209€, nga të cilat, 359,900€ janë shfrytëzuar për financimin e pagave dhe mëditjeve për shërbimet e përgjithshme mjekësore dhe strehim.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prizrenit në vitin 2022 ishin 7,538,665€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat në mbeturina, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja, participimet, dhe taksat tjera komunale.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Prizrenit ka përfituar 1,352,660€ të hyra nga gjobat në trafik, të hyra në vlerë 54,921€ nga gjobat e gjykatave, dhe 11,851€ të hyra nga Agjencia e Pyjeve. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës së Prizrenit i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për tu shpenzuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet | 2020 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Totali i të hyrave | 7,174,027 | 7,174,027 | 7,538,665 | 7,952,471 | 5,971,583 |
| Të hyrat tatimore | 2,861,732 | 2,861,732 | 2,572,438 | 3,168,586 | 2,205,372 |
| Të hyrat jo tatimore | 4,312,295 | 4,312,295 | 4,944,441 | 4,774,606 | 3,765,726 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 21,785 | 9,279 | 485 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 të Komunës së Prizrenit ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raportet periodike lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2021. Raporti i auditimit për vitin 2021 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, 9 rekomandime janë zbatuar, 5 nuk janë adresuar, 1 rekomandim pjesërisht i zbatuar, dhe 1 rekomandim nuk është më i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2021 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|-------------------|---|--|-------------------------|
| 1. | Baza për opinion | Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | Keqklasifikime të shpenzimeve janë hasur edhe këtë vit. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 2. | Baza për opinion | Kryetari duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet sistemit për të hyrat nga taksat për mbeturina, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i llogarive të arkëtueshme. | Edhe këtë vit janë hasur pasaktësi në saldën e LL/A për mbeturina. | Nuk ka filluar zbatimin |

| | | | | |
|----|---------------------|--|---|------------------------|
| 3. | Baza për opinion | Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontrole adekuate/ rigoroze mbi kontratat për projekte kapitale dhe mbi komisionet/organet mbikëqyrëse të punëve/materialit të furnizuar. Po ashtu, menaxhmenti të shtojë mekanizmat për kontroll më të avancuar në mbikëqyrjen e kontratave dhe pagesave për projektet e tilla. | Nuk janë hasur raste që është nënshkruar raporti i pranimit pa u bërë pranimi i mallrave/shërbimeve. | I zbatuar |
| 4. | Baza për opinion | Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale. Po ashtu, duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasurisë për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. | Pasuritë kapitale janë regjistruar në SIMFK, por programi e-pasuria për regjistrimin e pasurisë jokapitale nuk përdoret nga Komuna. | Pjesërisht i zbatuar |
| 5. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë, që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë. | Edhe këtë vit ka pagesa si rezultat i vendimeve gjyqësore / përmbarrimore. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 6. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i formuar për pranimin e mallit, të jetë me personel kompetent, në mënyrë që të pranoj mallin e porositur sipas procedurave dhe kriterëve të specifikuar. | Nuk janë hasur parregullsi në pranim të mallrave/pajisjeve. | I zbatuar |
| 7. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë, që më rastin e pranimit të shërbimeve, furnizimeve të parashihen të gjitha pozicionet/ artikujt përmbledhës të situacioneve paraprake si parakusht i faturimit dhe ekzekutimit të pagesave. Njëkohësisht, të sigurojë se shërbimet/ furnizimet, janë kryer sipas sasisë dhe vlerës së përcaktuar me kontratë. | Nuk janë hasur raste të tejkalimit të +/-30% të vlerës së kontratave publike kornizë. | I zbatuar |
| 8. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë, në rastin e zbatimit të kontratave me çmime për njësi, të këtë përdorim efikas të kontratave, ashtu që në proceset prokuruese të përdoren procedurat e duhura të llojeve të kontratave. | Nuk janë hasur raste që janë përdorur procedurat jo adekuate të prokurimit. | I zbatuar |
| 9. | Të hyrat | Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual. | Janë ndërmarrë veprime, nuk zbatohet më zbritja për banim parësor për tatimpaguesit pa numër personal. | I zbatuar |

| | | | | |
|-----|-------------------------------------|--|--|----------------------------|
| 10. | Të hyrat | Kryetari duhet të sigurojë, që do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifave për amvisëritë e caktuara. | Janë ndërmarrë masa dhe është hartuar rregullorja e brendshme që rregullon çështjet për amvisëritë e caktuara. | I zbatuar |
| 11. | Pagat dhe mëditjet | Kryetari duhet të sigurojë, që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitive zyrtare që janë të emëruar dhe të siguroj harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit. | Rekomandimi i vitit të kaluar tashmë trajtohet përmes ligjit për pagat në sektorin publik. | Nuk është i aplikueshëm më |
| 12. | Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë | Kryetari duhet të shtojë kontrollet me rastin e ekzekutimit të punëve, ashtu që të sigurojë se është bërë pranimi i situacioneve të nënshkruara para pranimit të faturave, dhe të sigurojë se pagesat janë kryer me rregull dhe në kohë. | Nuk janë hasur raste të pagesave pa aprovim të situacioneve të punimeve. | I zbatuar |
| 13. | Pasuritë | Kryetari duhet të sigurojë, që procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë. | Inventarizimi i pasurisë është bërë para përgatitjes së PVF. | I zbatuar |
| 14. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni i formuar të rishikoi faturat e shlyera ndër vite dhe të bëjë një vlerësim të gjendjes faktike të borxheve. | Janë ndërmarrë veprime duke vlerësuar gjendjen faktike. | I zbatuar |
| 15. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të sigurojë, që obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit. | Edhe këtë vit janë identifikuar vonesa në pagesën e obligimeve. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 16. | Detyrimet Kontigjente | Kryetari duhet të sigurojë, që detyrimet kontigjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotë mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV. | Detyrimet kontigjente nuk janë shpalosur drejtë në PVF e vitit 2022. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit




Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetar i Komunës
Shaqir Totaj

Data: 20.06.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.